

Festa e shkollave të klasave nga 5P deri në 8P – E Premte, 28 qershor 2019

INFORMACIONI PËR PRINDËRIT E NXËNËSVE TË KLASAVE NGA 5P DERI NË 8P

Përpara festës

Gjatë qershorit, prindërit që kanë fëmijë të klasave nga 5P deri në 8P në një shkollë fillore të Qytetit të Gjenevës, marrin një fletëpalosje me informacione për festën.

Me këtë fletëpalosje, një « pije e mirë » pa alkool i ofrohet të gjithë nxënësve. Fletëpalosja shpërndahet në standat e shoqatave të përfaqësuara në parkun e Bastions, nga ora 17.00 deri në orën 22.30 (*fletëpalosja për t'u shkarkuar në fund të faqes*).

Dita e festës

**Festa e klasave nga 5P deri në 8P është e hapur për të gjithë e të gjitha !
Ejani familjarisht për të përfituar prej argëtimit, spektakleve dhe lojrave falas!**

Vendosuni në tavolina dhe ejani të shijoni specialitetet e kuzhinës të propozuara prej shoqatave, e gjitha në ritmet e muzikës!



Manifestimi do të zhvillohet sido që të jetë koha.

Parku i Bastions

Ora 17.00: Hapja e festimeve

Argëttime, lojëra, spektakle dhe shëtitje/ pije freskuese/ushqim/muzikë.

Ora 22.00 : Spektakël me zë dhe drita përpara Pallatit Eynard

Një spektakël i patransmetuar më parë, për herë të parë në Gjenevë

Ora 22.30 : Mbyllja e festimeve



Manifestimi do të zhvillohet sido që të jetë koha.



Fëmijët do të paraqiten drejtpërdrejt në vend, të drejtuar prej prindërve të tyre dhe **në përgjegjësinë e tyre të plotë gjatë gjithë mbrëmjes**



Është formalisht e ndaluar të lihen fëmijët të hidhen nga muri i reformuesve dhe/ose të lahen në rezervuar



Shërbimi i shkollave dhe institucioneve për fëmijë
022.418.48.38

Hyrja në parkun e Bastions

Tramvaje 12-18

Autobusë 3, 5, 36

Stacioni: Place de neuve